

**RELACION
PËR PROJEKTLIGJIN
‘PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8811, DATË 17.5.2001,
‘PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË
DREJTËSISË’, I NDRYSHUAR’**

Reformimi i sistemit gjyqësor është një nga prioritet kyçe të maxhorancës së dalë nga zgjedhjet e 23 qershorit 2013, veçanërisht në drejtim të konsolidimit të parimeve bazë të shtetit të së drejtës.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë është organ kushtetues, me rol thelbësor në mirëfunksionimin e sistemit gjyqësor. Nëpërmjet ushtrimit të kompetencave të tij ligjore, KLD monitoron veprimtarinë gjyqësore, jo vetëm nëpërmjet procesit të inspektimit, por veçanërisht nëpërmjet vlerësimit profesional të gjyqtarëve, duke kontribuar në rritjen e integritetit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor.

Në shumë raste, veprimtaria e KLD-së ka qenë objekt i kritikave nga opinioni publik dhe është kthyer në një faktor, që perceptohet në rastin më të mirë si i pafuqishëm për të ushtruar presionin pozitiv brenda sistemit të drejtësisë e në rastin më të keq si favorizues i fenomenit të korrupsionit dhe mungesës së llogaridhënies.

Ky shqetësim është parashtruar edhe gjatë raportimit që ministri i Drejtësisë bëri përpara Komisionit të Ligjeve në datë 27 maj 2014. Situata e papranueshme në emërimin e kryetarëve të gjykatave, komandimi me afate të tejjzgjatura, vetëpromovimi i anëtarëve të KLD-së gjatë kohës së ushtrimit të mandatit u theksuan si elementët kryesorë që kanë sjellë një nevojë të ngutshme të kryrjes së ndryshimeve ligjore, që normojnë funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Për këtë arsye, ky projektligj i kushton një vëmendje të veçantë problematikave që kanë shoqëruar veprimtarinë e KLD në këto vitet e fundit, si dhe nevojave për reformimin e legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e këtij organi kushtetues, në funksion të rritjes së transparencës, përgjegjshmërisë dhe efijencës.

Disa çështje shqetësuese, që janë vërejtur gjatë ushtrimit të kompetencave nga ana e KLD-së, të tilla që lidhen kryesisht me mugesën e vullnetit për të zbatuar ligjin dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, për të cilat çojmë se duhen dhënë zgjidhje të menjëhershme nëpërmjet ndërhyrjeve ligjore, mund të përmbliken si më poshtë:

Është fakt i pamohueshëm se Këshilli i Lartë i Drejtësisë prej mëse 2 vjetësh nuk përmbushi misionin e tij ligjor në lidhje me emërimin e Kryetarëve të Gjykatave. Një situatë e tillë e papranueshme sigurisht që ka ndikuar në performancën e drejtimit të gjykatave përsa kohë titullarët e tyre janë ndierë vulnerabël për shkak të përkohshmërisë së tyre në detyrë, në mungesë të emërimit përfundimtar. Kjo situatë paligjshmërie jo vetëm ka sjellë papërgjegjshmëri në drejtimin gjykatave, por edhe ka stimuluar korrupsionin. Rasti i gjykatës së rrethit gjyqësor Pukë, ku kryetari ishte i komanduar prej vitesh, është shembulli më tipik se si korrupsioni kishte përfshirë gjithë hallkat e kësaj gjykate.

Në këtë kuptim duhet të gjejë rregullim ligjor të menjëhershëm mënyra e plotësimit të vendit të mbetur vakant të drejtuesit të gjykatës, për të mos lejuar më në të ardhmen situata të shkeljes flagrante të ligjit, ku gjyqtarët e komanduar kanë drejtuar gjykata për vite të tëra.

Po kështu, do të duhet të gjejë rregullim ligjor përmes këtyre ndryshimeve, çështja e konfliktit të interesit të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të cilët promovohen në detytë, gjatë ushtrimit të mandatit të tyre në këtë organ. Pavarësisht ndryshimeve ligjore në ligjin për Konferencën Gjyqësore Kombëtare, lidhur me kufizimet për konfliktin e interesit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë në mënyrë sistematike ka shpërfillur ligjin dhe anëtarët e tij janë vetëpromovuar.

Një tjetër problematikë shqetësuese është konstatuar me mungesën e transparencës në veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sidomos, në lidhje me vendimmarrjen. Për këtë arsye, është i nevojshëm sanksionimi i disa rregullave procedurale, sikurse praktikohen edhe nga organe të tjera kolegjiale, në zbatim të parashikimeve ligjore për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale. Është e papranueshme që mbledhjet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të mos evidentohen nëpërmjet përpilimit të procesverbaleve të firmosura nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ndryshimet në ligj, në këtë aspekt do të shërbenin në rritjen e transparencës në vendimmarrjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe rritjen e përgjegjshmërisë së anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përkundërt zbatimit korrekt të ligjit. Mungesa e transparencës dhe mosparashikimi i rregullave të qarta mbi veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë janë haptazi premisë për korrupsionin.

Sigurisht që përgjegjshmëria është një element shumë i rëndësishëm i sjelljes dhe qasjes kushtetuese të institucioneve, e në këtë drejtim edhe i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Thënë kjo, është krejtësisht jo normale që ligji organik i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk parashikon se në cilat raste dhe për çfarë mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Po kështu, shkeljet e vazhdueshme të ligjit në veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të pasqyruara gjërësisht dhe në media, i bëjnë të mirëpritur ndryshimet ligjore, me theks përgjegjshmërinë dhe luftën kundër korrupsionit.

Ndryshimet kushtetuese dhe ato që i pasuan në Kodin e Procedurës Penale lidhur me imunitetin e gjyqtarëve, sjellin domosdoshmërinë e pasqyrimit të tyre edhe në ligjin organik të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Tashmë ka rënë pengesa për kërkimin e autorizimit për fillimin e procedimit penal. Referuar kësaj shtate të re kushtetuese dhe ligjore, edhe pezullimi i mundshëm i gjyqtarit ndaj të cilit fillohet procedimit penal vlerësojmë se do të duhet të lidhet me momentin e fillimit të çështjes penale.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar”, gjen mbështetje në nenin 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe përmban 10 nene.

Nëpërmjet nenit 1, të projektligjit propozohet shtimi i pikës 1.1, pas pikës 1 të nenit 6, të ligjit nr.8811/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, propozim që, vjen si nevojë e frenimit të fenomenit të promovimit të vetvetes nga ana e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, gjatë ushtrimit të mandatit të tyre. Pika 1 e nenit 6 të ligji, parashikon se anëtarët e zgjedhur qëndrojnë në detyrë për një periudhë 5-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme. Ndërkohë, në praktikë vihet re tendenca e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të dhënë dorëheqjen përpara mbarimit të mandatit, duke u promovuar në sistemin gjyqësor, në sajë të shfrytëzimit të lidhjeve të krijuara mes tyre.

Për shmangien e këtij fenomeni abuziv, në pikën 1.1 është parashikuar se nëse anëtari i zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare jep dorëheqjen përpara mbarimit të afatit 5-vjeçar, ai nuk mund të transferohet apo të ngrihet në detyrë, deri në përfundim të periudhës së parashikuar në paragrafin 1 të nenit 6.

Në nenin 2, të projektligjit parashikohet shtimi i shkronjave “f” dhe “g”, pas shkronjës “ë”, të pikës 1, të nenit 7 “Mbarimi i mandatit”, duke parashikuar konkretisht si më poshtë:

*“f. Anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi, shkarkohen për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit.
g. Anëtarët e zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, shkarkohen për shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit.”*

Ky parashikim bëhet me synim shprehjen në mënyrë eksplicite se shkelja e Kushtetutës dhe ligjit gjatë ushtrimit të detyrës nga ana e anëtarëve të KLD-së, të zgjedhur nga Kuvendi apo nga KGJK-ja, përbën shkak për mbarimin e mandatit të tyre, duke shmangur kështu sjelljet abuzive gjatë ushtrimit të detyrës.

Në nenin 3, të projektligjit, parashikohet riformulimi i pikës 2, të nenit 10, duke parashikuar që, kur Këshilli i Lartë i Drejtësisë çmon se zgjedhja dhe qëndrimi në detyrë i anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, nuk është në përputhje me ligjin, me vendim të arsyetuar pezullon ushtrimin e mandatit dhe i kërkon Konferencës Gjyqësore Kombëtare zhvillimin e zgjedhjeve të reja.

Neni 4, i projektligjit parashikon një përmirësim të përmbajtjes së nenit 14 të ligjit aktual “Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, nëpërmjet shtimit të dy paragrafëve, si më poshtë:

*“6. Për Kryeinspektorin dhe inspektorët, çdo 2 vjet, kryhet vlerësimi profesional dhe etik, sipas kriterëve e procedurave të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.
7. Brenda tremujorit të parë të çdo viti, Inspektorati, nëpërmjet Kryeinspektorit, i paraqet Këshillit të Lartë të Drejtësisë një raport mbi veprimtarinë e tij në vitin paraardhës, në të cilin duhet të gjejnë pasqyrim problematikat e trajtuara dhe rezultatet e punës.
Raporti i përgatitur nga Inspektorati paraqitet nga Zëvendëskryetari për diskutim në mbledhjen më të afërt të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.”*

Duke mbajtur në konsideratë detyrat e rëndësishme që ligji i ngarkon Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sidomos në lidhje me vlerësimin e performancës së gjyqtarëve, ku vlerësimi bazohet kryesisht në veprimtarinë që kryejnë inspektorët e KLD-së, është e domosdoshme që për këta të fundit, të kryhet vlerësimi profesional dhe etik sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga KLD-ja.

Gjithashtu, në funksion të sa më sipër, është parashikuar detyrimi i hartimit dhe paraqitjes së një raportimi vjetor, para KLD-së, mbi veprimtarinë e Inspektoriatit gjatë vitit paraardhës, ku duhet të gjejnë pasqyrim problematikat e trajtuara dhe rezultatet e punës së kësaj strukture.

Ky parashikim është bërë me qëllim, rritjen e performancës dhe efikasitetit të veprimtarisë së Inspektoriatit të KLD-së, si dhe kontrollin e rezultateve të punës së tyre.

Në nenin 5, të projektligjit parashikohet një riformulim i nenit 21 të ligjit organik si vijon:

“1. Në rastet e arrestit, heqjes së lirisë në cfarëdolloj forme, ushtrimit të kontrollit personal ose të banesës, së gjyqtarit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mblidhet brenda 24 orëve dhe vendos për kërkesën e paraqitur nga prokurori.

1.1 Në rastin kur është regjistruar procedimi penal ndaj një gjyqtari Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos pezullimin e gjyqtarit nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë.

Në rastet kur fajësia nuk provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë të gjykatës, gjyqtari ka të drejtë të kthehet në punën e tij të mëparshme dhe të marrë pagën e plotë që nga koha e pezullimit.”

Ndryshimet e mësipërme propozohen duke patur si synim përputhshmërinë e ligjit aktual organik me ndryshimet e fundit kushtetuese dhe ato të Kodit të Procedurës Penale mbi imunitetin e gjyqtarëve, qeshpesh bëhet pengesë për hetim të shpejtë dhe më eficient të veprimeve korruptive nga ana e gjyqtarëve.

Në nenin 6, të projektligjit parashikohet se, në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë rrëzon masën disiplinore të propozuar nga Ministri, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të vendosë një masë disiplinore me të lehtë.

Parashikimi i mësipërm, aktualisht ekziston në Rregulloren për procedimin disiplinor të gjyqtarëve, të miratuar me Vendimin nr.137, datë 21.02.2003 të KLD-së, i ndryshuar. Është parë e arsyeshme që ky parashikim të sanksionohet në ligj.

Nënenin 7, të projektligjit, parashikohet mënyra e mbajtjes së procesverbalit të mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, elementët dhe mënyra e miratimit i tij. Ky ndryshim, vjen si rrjedhojë e përshtatjes së dispozitës ekzistuese me ligjin kuadër nr.8480/1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

Në nenin 8, të projektligjit parashikohen shprehimisht kushtet dhe rregulla të përgjithshme për emërimin e kryetarëve të gjykatave. Propozimi i shtimit të një neni, që trajton këtë situatë, lidhet pikërisht me faktin e plotësimit të vakumit ligjor, si edhe të problematikave të evidentuara deri tani në këtë drejtim.

Ky propozim jo vetëm forcon normën ekzistuese, por përcjell edhe një qëllim madhor, atë të luftës kundër korrupsionit në rradhët e gjyqësorit dhe të përmirësimit të performancës së kryetarëve të gjykatave në këtë gjithë vendin. Parashikimi konkret aktualisht është i parashikuar në vendimin Nr. 227/2, datë 28.03.2008 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për funksionin drejtues në gjykata”, por asnjëherë nuk është zbatuar nga KLD-ja që është sot në ushtrim të mandatit. Forcimi i normës, pra ngritja në nivelin e ligjit të këtij parashikimi, synon në të njëjtën kohë rritjen e përgjegjshmërisë së personave, të cilët do të duan të promovohen në këto detyra, por edhe rritjen e përgjegjshmërisë për të zbatuar ligjin të vetë anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Konkretisht parashikohet se:

“1.Vendi vakant për pozicionin e kryetarit të gjykatës, shpallet si i tillë, 3 (tre) muaj përpara përfundimit të mandatit katërvjeçar të kryetarit të gjykatës. Afati tre muaj shërben për evidentimin e kandidaturave që konkurrojnë në pozicionin e kryetarit të gjykatës dhe mbledhjen e materialeve dhe të dhënave mbi bazë të të cilave do të bëhet përzgjedhja.

2.Emërimi i kryetarit të ri nuk mund të bëhet përpara deklarimit të mbarimit të mandatit të plotë të kryetarit ekzistues dhe në çdo rast jo më vonë se një muaj nga mbarimi i mandatit të tij.

3.Në rastet kur vendi i kryetarit në një gjykatë mbetet vakant për një nga situatat e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, delegon një nga gjyqtarët e kësaj gjykate për të kryer përkohësisht detyrën e kryetarit të gjykatës. Vendi vakant në këtë rast, duhet të plotësohet brenda tre muajve nga krijimi i tij.

4.Kryeinspektori i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, një herë në dy vjet ose kur kërkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, paraqet përpara Këshillit një raport për punën e kryer nga kryetari i gjykatës. Raporti i Kryeinspektorit bazohet edhe në:

a)raportin e të deleguarit pjesëmarrës të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në analizat vjetore të gjykatës, e veçanërisht për punën e kryetarit;

b)vizitat e Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykata gjatë mandatit të kryetarit;

c)materiale që vijnë nga Ministri i Drejtësisë;

ç) materiale të tjera që rezultojnë nga verifikimet apo kontrollet gjatë periudhës që ai ka qenë në detyrën e kryetarit të gjykatës.

5.Shqyrtimi i kandidaturave bëhet nga një komision i posaçëm i cili kryesohet nga Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

6.Përbërja, rregullat e funksionimit të komisionit të shqyrtimit të kandidatëve dhe procedurat e verifikimit dhe të testimit të tyre caktohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.”

Në nenin 9 të projektligjit parashikohet se shqyrtimi i procedimit disiplinor bëhet brenda një muaji nga data e depozitimit të dokumentacionit përkatës nga Ministri i Drejtësisë, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Ky ndryshim propozohet me qëllim, shmangien e zvarritjes dhe shqyrtimin e procedimit disiplinor brenda një afati të përcaktuar.

Neni 10 parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit.

DEPUTETËT PROPOZUES